FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

RAPORTI I KAMPIONATIT TË KOSOVËS NË GJIMNASTIKË ARTISTIKE 2025

Data: 06 Dhjetor 2025
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës së Kosovës
Mbështetës: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ice Power Kosova, Lulishte Say it With Flowers, Aliçkaj Print, Mar Events dhe Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

Përshkrimi.
Më 06 dhjetor 2025, Federata e Gjimnastikës së Kosovës organizoi Kampionatin e Kosovës në Gjimnastikë Artistike për Femra dhe Meshkuj. Ky kampionat përbën garën më të rëndësishme vendore të vitit, ku garojnë gjimnastet/ët më të mirë të vendit në të gjitha grupmoshat dhe kategoritë.
Pjesëmarrës në garë ishin 9 klube dhe 82 gjimnaste:
1. Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria,
2. Klubi i Gjimnastikës Elita,
3. Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova,
4. Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan,
5. Klubi i Gjimnastikës Kulina,
6. Klubi i Gjimnastikës Omnisport,
7. Klubi i Gjimnastikës Vushtrria
8. Klubi i Gjimnastikës Ritmike Ritmiks
9. Klubi i Gjimnastikës Ritmike Poise

Përgatitjet para garës:
Një ditë para garës, më 05 dhjetor, nga ora 08:30, punëtorët e angazhuar nga FGJK së nën mbikqyrjen nga Kryetari Shkumbin Maqastena, Sekretari i Përgjithshëm Amir Tahiraga dhe Sekretari Teknik Arlind Shaqiri realizuan bartjen e veglave nga Pallati i Rinisë dhe Sporteve deri në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit. Në mbrëmje, nga ora 21:30, pasi u lirua salla e madhe në fakultet, u vendosën të gjitha veglat sipas standardeve, me ndihmën poashtu edhe të Sherife Qerimit, Abeliana Bregut dhe Ard Kryeziut.

Ecuria e Garës:
Gara u zhvillua në tri disiplina: parter, tra dhe kapërcime, ndërsa kishte ndarje të vendeve edhe për shumë-garësh dhe ekipore.
Një fjali hyrëse u mbajt nga Kryetari i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, z. Shkumbin Maqastena dhe e shpalli zyrtarisht të hapur garën nga ora 10:15.

Paradite:
09:00 - Takimi i trajnerëve, gjyqtarëve dhe organizatorëve
09:15 - Filluan nxemjet
10:15 - Filloj zyrtarisht gara e grupit paradite.
13:30 - Ceremonia e medaljeve dhe shpërblimeve për grupin e parë
Pasdite:
13:50 - Filluan nxemjet për grupin e pasditës
14:30 - Filloj zyrtarisht gara e grupit pasdite
18:30 - Përfundoj kampionati i Kosovës
19:00 – Bartja e veglave prapa nga salla e garave deri te Pallati i Rinisë

Gjyqtarët e angazhuar në tre veglati ishin si më poshtë.
Parter: Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri, Ard Kryeziu dhe Doruntinë Ibrahimi
Tra: Abeliana Bregu, Amir Tahiraga dhe Arlind Shaqiri
Kapërcime: Ard Kryeziu, Besim Halilaj dhe Doruntinë Ibrahimi.
Ndihmës teknikë në garë:
Besnik Latifi, Fiona Konxheli dhe Drinesa Qerimi
Moderatore: Rizonë Mustafa

Gjimnastet ishin të ndara sipas kategorive:

Para-fatos / Para-yllka 2019 Para-fatos / Para-yllka 2018 Fatos / Yllka 2017 Fatos / Yllka 2016 Para-pioniere 2015–2014	Pioniere 2013–2012 Juniore 2011–2010 Seniore 2009+

Gara ekipore sipas manualit të FGJK-së, u zhvillua në dy grupe, grupi i të rejave që kishin kriteret e njejta të garës me lehtësimi dhe kërkesa tjera të kompozimit, dhe grupi i më të rriturave që garonin sipas rregullave të Kodit të Poentimit nga FIG.
Fillimisht gara u zhvillua vetem në parter, ndërsa trau dhe kapërcimet u bënë me rotacion. Që gara të eci mire dhe rrjedhshëm ndikoj shumë edhe moderatorja që thërriste me emër secilën gjimnaste në secilen vegël. Poashtu klubet e kan pasur një javë më herët në dispozicion listen startuese.

Ceremonua e ndarjes së medaljeve u bë pas përfundimit të garës së grupit të parë dhe përsëri pas garës së grupit të dytë. Gjimnastet fituese u shpërblyen me dhurata nga sponzorët e kampinatit.

Përfundim

Kampionati i Kosovës, i mbajtur më 06 dhjetor 2025, u realizua me sukses të plotë. Organizimi para, gjatë dhe pas garës u krye në mënyrë profesionale falë punës së koordinuar të stafit të FGJK-së, gjyqtarëve, vullnetarëve dhe punëtorëve teknikë. Gara pati pjesëmarrje të lartë, interesim të madh nga publiku. Risi në këtë kampionat ishte edhe paraqitja e rezultateve në TV live, të seciles gjimnaste që garonte në displinen parter. Gjithashtu gjimnastet nga Gjimnastika Ritmike bënë përformancat e tyre gjatë kampionatit.

Në këtë kampionat u vrejt që niveli i gjimnastikës në Kosovë është rritur, dhe gjimnastet prezantuan elemente të vështërsise së lartë dhe me teknikë të bukur, krahasuar me vitet e kaluara. Kjo tregon që niveli i gjimnastikës në vend po shkon duke u rritur.

Federata falënderon klubet për përgatitjen dhe disiplinën, gjyqtarët për punën profesionale dhe institucionet mbështetëse për kontributin e tyre.

Disa foto nga gara:
















FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK - KGF

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

Data e raportit: 10 Dhjetor 2025